



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Nr. i Protokollit: 14-111/01-101963/26
Datë: 09.07.2026

Në bazë të nenit 78 paragrafi 2, nenit 80 dhe 81 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publikë të Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, nenit 5, nenit 6, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3, nenit 7 si dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Komuna e Prishtinës shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Nr.		Titulli i vendit të punës	Vendi i lirë	Klasa / Koefficienti i pagës
1	QKMF	Specialist i Mjekësisë Familjare	4	H8 / 13
2	QKMF	Mjek i përgjithshëm	12	H10 / 8.4
3	QKMF	Stomatolog	6	H10 / 8.4
4	QKMF	Specialist i Radiologjisë	1	H8 / 13
5	QKMF	Specialist i Biokimisë	1	H8 / 13
6	QKMF	Infermier i përgjithshëm	16	H17 / 6.4 (Bachelor) H20 / 6.1 (Shkolla e mesme)
7	QKMF	Teknik Laborant	5	H17 / 6.4 (Bachelor) H20 / 6.1 (Shkolla e mesme)
8	QKMF	Asistent i Stomatologjisë	6	H20 / 6.1
9	QKMF	Teknik i Radiologjisë	4	H17 / 6.4 (Bachelor) H20 / 6.1 (Shkolla e mesme)
10	QKMF	Asistent administrativ	3	GJ41 / 5.0

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

I. Emri i grupit: Specialist i Mjekësisë Familjare- Katër (4) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koefficienti: H8 / 13.

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Shefi i Njesisë së QMF-së, Udhëheqësi i Sektorit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave të Mjekut të Familjar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuara në dëshmi, përmes bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët tjerë të ekipit të mjekësisë familjare si portë hyrëse, për të gjithë kërkuarët e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe pikë referuese për specialistët konsulentë në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.

Mjeku familjar ka për detyrë të promovojë dhe përparojë shëndetin e individit/pacientit dhe familjes, duke pasur parasysh aspektin demografik dhe ambientat. Ofron kujdes gjithëpërfshirës dhe përkrahje psikosociale-fizike, për të gjithë pa dallim kulture, besimi, race, ngjyre, gjinie, moshe, statusi social apo vlera të perceptuara ekonomike.

Kujdesi ndaj pacientit:

1. Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi;
2. Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar;
3. Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar;
4. Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë;
5. Bënë zbulimin e hershëm të shtatzanisë, ofron kujdes antenatal dhe kujdeset për planifikim familjarë;
6. Kujdeset për shëndetin e fëmijëve përmes menaxhimit të integruar të sëmundjeve të fëmijëve (sipas MISF-it), përcjelljes sistematike të rritjes dhe zhvillimit të foshnjave dhe fëmijëve si dhe kujdeset për adoleshentë dhe tinxherë;
7. Kujdeset për shëndetin e meshkujve;
8. Ofron kujdes për shëndetin e të moshuarve dhe kujdes paliativ;
9. Bënë identifikimin e hershëm të shenjave alarmuese që sigurojnë kujdes të përshtatshëm dhe të ofrojnë kujdes të vazhdueshëm për pacient me qregullime të shëndetit mendor;
10. Ofron kujdes për rastet urgjente dhe referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;
11. Kujdesi për lëndimet e vogla (kirurgjia e vogël);
12. Interpretton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike, komunikon rezultatet në përshtatje me kornizën kohore;
13. Bënë edhe hulumtime tjera diagnostikuese varësisht nga kompetencat e fituara me programe specifike të EVM;
14. Komunikon ose konsultohet me specialist të niveleve të tjera sipas nevojës;
15. Referon pacientin për kujdes spitalor dhe kërkon informatën kthyesë për përcjelljen e pacientit;
16. Kujdesi i vazhdueshëm shëndetësor, përfshirë vizitat shtëpiake;
17. Kujdes i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse dhe programe kontrolluese për sëmundjet kronike jo ngjitëse:
 - Hipertension,
 - Astma,
 - Diabeti,
 - Sëmundjet malinje,
 - Sëmundjet kardiovaskulare,
 - Sëmundje të shëndetit mendor, etj.
18. Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike):
 - TB,
 - Hepatit,
 - Sëmundje seksualisht transmise,
 - HIV/AIDS, etj
19. Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete):
 - Zbatimi i programit të vaksinimit,
 - Edukimi shëndetësor, etj.

Detyrat e ekipit:

1. Inkurajon punën ekipore (mjekun e përgjithshëm, stomatologun, infermieret familjare, infermieret në komunitet dhe asistentin e stomatologut);
2. Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe udhëheqë anëtarët e ekipit për zgjedhjen e tyre;
3. Përcakton anëtarët e ekipit në përputhje me nevojat e pacientit, aftësitë dhe kualifikimet e stafit për të përmbushur nevojat e institucionit;
4. Pjesëmarrje në trajnime, vlerësim të kompetencave, orientim dhe edukim për të punësuarit e rinj;
5. Komunikon qartë, sakt dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë kënaqshmëritë në punë të personelit;
6. Shërben si burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarët tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.

Detyrat administrative:

1. Krijimin e listës së pacientëve sipas moshës gjinisë dhe plotësimi i rregullt dhe i saktë i dosjeve mjekësore ku përfshihen edhe caktimi i vizitave të rregullta për pacientët;
2. Evidenton dhe raporton rastet e sëmundjeve infektive, sëmundjet kronike jo masovike dhe sëmundjeve malinje në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik;
3. Vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi;
4. Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë;
5. Nënshtrohet programit nacional të Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor;
6. Përkujdeset për konfidencialitetin e individit;
7. Përcjellja e sëmundshmërisë;
8. Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut;
9. Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjal dhe sjell vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve;
10. Merr pjesë edhe në hartimin protokolleve klinike;
11. Zhvillon audite mjekësore në institucionin përkatës.
12. Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregon interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe të nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit.

Standardet e performancës:

1. Demonstron shkathtësi të larta klinike profesionale;
2. Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
3. Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
4. Respekton plotësisht konfidencialitetin;
5. Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.

Kualifikimi minimal:

1. Të ketë të kryer specializimin në Mjekësi Familjare;
2. Të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH/Oda përkatëse;
3. Të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara në EVM.

Kualifikimet e preferuara:

Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;

Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;

Të ketë shkashtësi pune e pavarur dhe në ekip;

Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter,

Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

II. Emri i grupit: Mjek i përgjithshëm - Dymbëdhjetë (12) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti : H10 / 8.4.

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Shefi i Njesisë, Udhëheqësi i Sektorit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave të Mjekut të përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuara në dëshmi, përmes bashkëpunimit dhe monitorimit të ngushtë nga ana e Mjekut Familjar.

Mjeku i përgjithshëm ka për detyrë të promovojë dhe përparojë shëndetin e individit/pacientit dhe familjes, duke pasur parasysh aspektin demografik dhe ambiental. Ofron kujdes gjithëpërfshirës dhe përkrahje psikosociale-fizike, për të gjithë pa dallim kulture, besimi, race, ngjyre, gjinie, moshe, statusi social apo vlera të perceptuara ekonomike.

Kujdesi ndaj pacientit:

1. Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi;
2. Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar;
3. Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar;
4. Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë;
5. Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve;
6. Kujdesi për personat e moshuar në nevojë;
7. Ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;
8. Interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike;
9. Komunikon ose konsultohet me specialist të mjekësisë familjare sipas nevojës;
10. Referon pacientin te specialist i mjekësisë familjare dhe për kujdes spitalor;
11. Kujdes i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse;
12. Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike);
13. Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete):
 - Zbatimi i programit të vaksinimit;
 - Edukimi shëndetësor, etj.

Detyrat e ekipit:

1. Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, infermieret familjare, infermieret në komunitet);
2. Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjidhjen e tyre;
3. Përcaktohet nga mjeku familjar si pjesë e ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit aftësitë dhe kualifikimet për të përmbushur nevojat e institucionit;
4. Merr pjesë në trajnime, vlerësim të kompetencave orientim dhe edukim;
5. Komunikon qartë saktë dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë kënaqshmëritë në punë.

Detyrat administrative:

1. Vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi;
2. Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë;
3. Nënshtrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
4. Përkujdeset për konfidencialitetin e individit;
5. Përcjellja e sëmundshmërisë nën mbikëqyrje të mjekut familjar;
6. Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut;
7. Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjell vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve;
8. Ndihmon mjekun familjar në zhvillimin e auditeve mjekësore në institucionin përkatës;
9. Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregon interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit.

Standardet e performancës:

1. Demonstron shkathtësi të optimale klinike profesionale;
2. Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
3. Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
4. Respekton plotësisht konfidencialitetin;
5. Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.

Kualifikimi minimal:

1. Diplomë e Fakultetit të Mjekësisë së Përgjithshme;
2. Të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH/Oda përkatëse;
3. Licencë valide për ushtrimin e profesionit të doktorit të mjekësisë së përgjithshme;
4. Të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara në EVM.

Kualifikimet e preferuara

1. Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
2. Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;
3. Të ketë shkathtësi pune e pavarur dhe në ekip;
4. Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter;
5. Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

III. Emri i grupit: Stomatolog- Gjashtë (6) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti : H10 / 8.4.

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Shefi i Shërbimit Stomatologjik, Shefi i Njesisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Kryen punët profesionale të ndërlidhur me shërbimin polivalent;
2. Bën shërimin, kiretazhën si dhe ekstraksionin e dhëmbëve;
3. Kryen të gjitha procedurat mjekuese urgjente: ndalja e dhimbjes, drenazha, largimi i urës, incizione, referime për shërimë spitalore apo egzaminime diagnostike shtesë;
4. Përshkruan barërat dhe e përcjellë gjendjen e pacientëve;
5. Është përgjegjës për plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit shëndetësor;
6. Përcjellë edukimin e mjekëve dhe të kuadrit të mesëm mjekësorë në praktikën profesionale obligative;

7. Bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor me qëllim të përbashkët ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe jep kontributin e tij;
8. Është përgjegjës për manipulimin e drejtë dhe rregullsinë e aparateve, të instrumenteve dhe kujdeset për gjendjen ordinancës;
9. Është përgjegjës për mbikëqyrjen e realizimit të procedurave që sigurojnë punën në kushte aseptike (dezinfektimin, sterilizimin) në ordinancën që punon, dhe sallën e operacionit;
10. Kryen edhe punët të tjera sipas urdhërit të shefit të njësisë me të cilët drejtpërsëdrejti bashkëpunon;
11. Sipas orarit dhe nevojave të institucionit kujdestaron natën, të dieleve dhe gjatë festave shtetërore;
12. Ruan konfidencialitetin e pacientit;
13. Kryen dhe punët të tjera nga lëmia e tij përkatëse, dhe në bazë të nevojës së shërbimit ofron edhe shërbime polivalente stomatologjike në njësitë organizative të QKMF-së;
14. Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Diplomë e Fakultetit të Stomatologjisë;
2. Të jetë i licencuar me licencë valide nga MSh/Oda përkatëse;
3. Licencë valide për ushtrimin e profesionit si doktor i stomatologjisë;
3. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

IV. Emri i grupit: Specialist i Radiologjisë- Një (1) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti : H8 / 13.

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Shefi i Shërbimit Radiologjik, Udhëheqësi i Sektorit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Kryen të gjitha egzaminimet radiologjike, mamografitë, egzaminimet echografike sipas referimeve nga Mjeku Familjar apo mjekët e profileve tjera,
2. Përpilon raportin mjekësor mbi të gjeturat diagnostike,
3. Në vazhdimësi mban kujdes për vete dhe për stafin mjekësor lidhur me rrezatimin dhe çdo herë në punën e tij mban indikatorin - dozimetrit për rrezet jonizuese,
4. Aplikon në vazhdimësi metodat bashkohore të diagnostifikimit,
5. Në vazhdimësi bën konsultimin me punëtorët e tjerë dhe udhëzon stafin e teknikëve radiolog në mënyrë që puna të jetë sa më kualitative,
6. Sipas nevojës është i obliguar që të përdorë uniformën mbrojtëse si masë preventive.
7. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve në kabinetin e radiologjisë dhe të raporton shefin e radiologjisë për mbarëvajtje të punës dhe ngecjet eventuale të paraqitura,
8. Sigurohet që i njejti gjithmonë të jetë në funksionin e duhur,
9. Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF,
10. Kryen edhe punët të tjera nga lëmia përkatëse.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Mjek/Specialist i Radiologjisë;
2. Të jetë i licencuar me licencë valide nga MSh/Oda përkatëse;
3. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

V. Emri i grupit: Specialist i Biokimisë- Një (1) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti : H8 / 13.

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Shefi i Njesisë, Shefi i Shërbimit të laboratorit qendror të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Kryen egzaminimet laboratorike sipas referimeve;
2. Përgaditë reagensat e nevojshme për punë, aktivizon aparaturat dhe mbikëqyrë punën e tyre;
3. Vlerëson cilësinë e reagensave dhe testeve, bën kalibrimin me kalibrator të aparaturave;
4. Mbikqyrë-monitoron materialet e marrura, evidencën dhe distribuimin e tyre;
5. Përcjellë në vazhdimësi procesin e sterilizimit dhe mjeteve për sterilizim, mbikqyrë aplikimin e të gjitha masave të nevojshme për punë në kushte aseptike;
6. Në raste të emergjencës pranon dhe kryen analizat laboratorike sipas kërkesës;
7. Raportet e analizave laboratorike i verifikon dhe i nënshkruan;
8. Aplikon të gjitha masat mbrojtëse për punën në laborator;
9. Aplikon të gjitha metodat kontrolluese, kalibruese të parapara me protokol të punës me qëllim të sigurimit të cilësisë së dhënies së shërbimit;
10. Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF;
11. Ruan konfidencialitetin e pacientit;
12. Kryen edhe punë të tjera nga lëmia përkatëse.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Specialist nga Biokimia Klinike;
2. Të jetë i licencuar me licencë valide nga MSh/Oda përkatëse;
3. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

VI. Emri i grupit: Infermier i përgjithshëm – Gjashtëmbëdhjetë (16) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti: H17 / 6.4 (Bachelor) H20 / 6.1 (Shkolla e mesme)

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Infermiera përgjegjëse, Kryeinfermierja e QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave për ofrimin dhe udhëheqjen e kujdesit infermior dhe bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e ekipit të mjekësisë familjare.

Infermieri/ja familjar/e (IF) në KPSH ka për detyrë të promovojnë dhe përparojnë shëndetin e individit/pacientit dhe familjes përmes ofrimit, delegimit, vlerësimit dhe bashkëpunimit gjithëpërfshirës profesional të kujdesit sipas procesit infermior, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni dhe race, duke ofruar përkrahje psikosociale dhe fizike, për individin/pacientin dhe familjen.

Infermieri/ja familjar/e është anëtar/e i/e ekipit të Mjekësisë Familjare, punon i/e pamvarur dhe me ekipet multi-profesionale dhe sugjeron detyrat e riorganizuar në praktikë, me qëllim të përmirësimit të performances së institucionit në tërësi.

Kujdesi ndaj pacientit:

1. Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermior të dokumentuar;
2. Reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën me shpejtësi;

3. Vlerëson, planifikon, zbaton dhe rivlerëson kujdesin infermieror të ofruar në përputhje me moshën, gjendjen fizike, psikosociale, kulturore dhe shpirtërore të individit/pacientit dhe familjes në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara;
4. Menaxhon rastet dhe avokon për të drejtat e tyre, duke qenë burim dhe person kontakti për ta;
5. Komunikon në mënyrë efektive me individin pacientin apo familjen dhe ofron kujdes të standardit të lartë dhe dokumenton punën e bërë;
6. Ofron promovim dhe edukim shëndetësor për individin/pacientin dhe familjen, me theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë për vetë kujdes konform moshës dhe nevojave të identifikuara;
7. Grumbullon dhe dokumenton të dhënat subjektive dhe objektive për individin/pacientin dhe rishqyrton informatat themelore të individit/pacientit duke u përqendruar në ambientin ku jeton, vetë kujdesin dhe planifikimin e mëtejshëm;
8. Ofron shërbime për të parandaluar sëmundjen dhe për të avancuar dhe promovuar jetë të shëndoshë dhe të sigurtë lidhur me shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar;
9. Ofron shërbimet e kujdesit: ante, peri dhe post-natal, imunizimin dhe vaksinimin, zhvillimin e fëmijëve, kujdesin për adoleshentë dhe të rinjë dhe shëndetin oral prevenues;
10. Ofron shërbime infermier orë duke përfshirë kujdesin terminal/paliativ;
11. Përgatitë dhomën e ekzaminimit me pajisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuara për vizitë, gjithashtu asiston gjatë ekzaminimit dhe procedurave të kërkuara;
12. Administron terapinë enterale dhe paranterale, të përshkruara nga mjeku familjar, me shkathtësi dhe përpikëri;
13. Respekton masat aseptike gjatë marrjes së mostrave laboratorike përfshirë edhe kontrollin e kualitetit dhe mirëmbajtjen e të gjitha testeve të shpejta laboratorike/diagnostike dhe informon menjëherë rezultatet me vlera jonormale të testeve laboratorike, të ordinuara nga mjeku familjar;
14. Përmban konfidencialitet të plotë për të gjitha çështjet që i përkasin individit pacientit dhe familjes, veprimtarisë së KPSH, përveç nëse është i i/e autorizuar me shkrim nga menaxheri;
15. Mbështet dhe kontribuon në hulumtime të kujdesit shëndetësor, që ndërlidhen me dëshmitë për siguri dhe praktikën efektive.

Detyrat e ekipit:

1. Inkurajohet nga puna ekipore (mjekun e familjar, mjeku i përgjithshëm, stomatologun, infermieret familjare, infermieret në komunitet dhe asistentin e stomatologut);
2. Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjidhjen e tyre;
3. Vepron në cilësinë e anëtarit të ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e institucionit për kujdesin sa më cilësor për individin/pacientin dhe familjen;
4. Merr pjesë në takime konsultative, profesionale, komunikojnë qartë saktë dhe krijojnë klimë të mire pune që rritë kënaqësitë e individit/pacientit dhe familjes;
5. Është burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarë tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.

Detyrat administrative:

1. Vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi;
2. Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtueshmëri me politikat shëndetësore në fuqi, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin profesional;
3. Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor në KPSH, duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj individit/pacientit dhe familjes;
4. Identifikon rëndësinë e kërkimit për të përmirësuar rezultatet e shëndetit për individin/pacientin;
5. Realizon veprimin e duhur dhe të sigurt, deponon dhe administron pajisjet, barnat dhe të gjitha informatat klinike në mënyrë të duhur dhe me një kosto efektive;
6. Merr pjesë në zhvillimin dhe përpilimin e udhëzimeve dhe protokolleve të shkruara, proceduarve për shërbimet infermiere;

7. Zbaton protokollet e praktikave infermierore të bazuara në dëshmi, mbledh të dhëna në mënyrë sistematike dhe vlerëson të dhënat aspektin fizik, socio-kulturor dhe mendor për shëndetin e individit/pacientit dhe familjes;
8. Merr pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e ekipit të mjekësisë familjare për të përmirësuar performancën e tij/saj dhe të institucionit;
9. Ka qëndrim pozitiv drejt ndryshimeve në përmirësimin e kujdesit dhe ngritjen e cilësisë përmes EVM.

Standardet e performancës:

1. Demonstron shkathtësi të optimale klinike profesionale;
2. Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
3. Demonstron dhe mbështetë standardet e përsosmërisë së shërbimeve sipas PVP;
4. Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
5. Respekton plotësisht konfidencialitetin;
6. Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.

Kualifikimi minimal:

1. Të ketë të kryer shkollën e mesme në drejtimin infermieri e përgjithshme/Bachelor i Infermierisë;
2. Të jetë infermier/e e regjistruar dhe licencuar në MSH;
3. Të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara në EVM.

Kualifikimet e preferuara

1. Të ketë të kryer edukimin për Infermieri Familjare;
2. Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
3. Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;
4. Të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip;
5. Të ketë njohuri të punës me kompjuter dhe të gjuhëve të huaja;
6. Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race;
7. Të ketë të kryer studimet universitare në drejtimin infermieri.

VII. Emri i grupit: Teknik Laborant - Pesë (5) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti: H17 / 6.4 (Bachelor) H20 / 6.1 (Shkolla e mesme)

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Tekniku përgjegjës i Njesisë së Radiologjisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Pranon dhe regjistron pacientet në librin e protokoleve dhe në mënyrë elektronike bazuar në program;
2. Kryen bashkëpagesat dhe të njëjtat i evidenton;
3. Përcjellë pacientin në hapësirat përkatëse, pranon mostrat për analiza laboratorike;
4. Kryen të gjitha analizat në bazë të referimeve e të cilat kryhen në shërbimin përkatës;
5. Vlerat e analizave të fituara i evidenton dhe të njëjtat i ofron për verifikim të biokimisti;
6. Sipas rekomandimeve të udhëheqësit në rast nevojë dhe me rekomandim të shefit merr mostra nga pacientët e palëvizshëm dhe në fazën terminale të jetës në vendbanimin e tyre;
7. Përgaditë reagensat për punë dhe bën ruajtjen e tyre në mënyrë adekuate;
8. Mirëmbanë aparaturën me të cilën punon dhe është përgjegjës për rregullsinë e saj;
9. Aplikon metodat e dezinfektimit dhe sterilizimit, kontrollon sterilizimin e mjeteve të punës;
10. Mbanë evidencën e rregullt të analizat laboratorike;
11. Kujdeset për konfidencialitetin e pacientit në punën e përditshme;
12. Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF;
13. Kryen edhe punë të tjera nga lëmia përkatëse.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Të ketë të kryer shkollën e mesme të mjekësisë-Laborant, Bachelor-Laborant ;
2. Të jetë i licencuar me licencë valide nga MSh/Oda përkatëse;
3. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

VIII. Emri i grupit: Asistent i Stomatologjisë - Gjashtë (6) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti : H20 / 6.1.

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Tekniku përgjegjës i Shërbimit të stomatologjisë, Shefi i Njesisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Menaxhon pranimin e pacientëve dhe evidentimin e të dhënave personale duke e regjistruar në protokol dhe caktimin e terminëve të radhës në formën manuale apo elektronike;
2. Kontrollon paraprakisht instrumentet duke evituar çdo parregullsi para fillimit të punës së mjekut;
3. Varësisht nga ndërhyrja përgatite pacientin, përcakton instrumentet e nevojshme për trajtim;
4. Përgatite barërat që kërkohen nga mjeku-stomatolog, gjithashtu asistojnë gjatë procedurave terapeutike;
5. Pas përfundimit të ndërhyrjes ato informojnë pacientin duke i dhënë shpjegimet e duhura dhe kohën kur doktori e përcakton për kontrollë apo termin të radhës;
6. Pas përfundimit të procedurave terapeutike largon mbetjet, duke e dezinfektuar me dezinficient vendin e punës, dezinfektojnë dhe sterilizojnë instrumentet dhe bëjnë përgatitjet për pranimin e pacientit të radhës;
7. Zbaton rregullat e mbledhjes së participimit, protokolon dhe dorëzon protokolet asistentit përgjegjës të shërbimit stomatologjik;
8. Mirëmban rregullisht ordinancën, kujdeset për furnizim me materiale nga depo stomatologjike dhe ndihmon në përgatitjen e raportit mujor;
9. Është përgjegjës për manipulimin e drejtë dhe rregullsinë e aparateve, të instrumenteve dhe kujdeset për pamjen estetike të ordinancës;
10. Sipas orarit kujdestaron natën, të dielën dhe gjatë festave shtetërore;
11. Kryen edhe punët të tjera profesionale sipas kërkesës të doktorit dhe të shefit;
12. Njohurit profesionale i plasun tek pacientet duke kryer detyrimet për edukim dhe promovim shëndetësorë;
13. Në rast të nevojave të shërbimit dhe kërkesës së mbikëqyrësit direkt ndihmon edhe kolegët për mbarëvajtje të procesit të punës;
14. Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF;
15. Kryen dhe punë të tjera nga lëmia e tij përkatëse.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Shkolla e e mesme e mjekësisë, drejtimi asistent i stomatologjisë, teknik i dhëmbëve/teknik dentar;
2. Të jetë i licencuar me licencë valide nga MSh/Oda përkatëse;
3. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

IX. Emri i grupit: Teknik i Radiologjisë - Katër (4) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti: H17 / 6.4 (Bachelor) H20 / 6.1 (Shkolla e mesme)

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Tekniku përgjegjës i Njesisë së Radiologjisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Pranon pacientët për shërbimet radiologjike, kontrollon rregullsinë e udhëzimit - mjekësor protokolon dhe evidenton të dhënat e pacientit, cakton terminin për egzaminim;
2. Kryen të gjitha procedurat e nevojshme të përgaditjes dhe pozicionimit të pacientit me qëllim të egzaminimit;
3. Përgaditë aparaturën për egzaminime dhe realizon ato sipas udhëzimeve të mjekut radiolog, përgaditë komorën për përpunimin e filmave;
4. Konsulton Radiologun për kualitetin e incizimit dhe cilësinë për të cilën edhe mbanë përgjegjësi;
5. Është i obliguar të bartë dozimetrimin personal, mjetet mbrojtëse të punës dhe i nënshtrohet matjeve të rrezatimit, vizitave të obliguara shëndetësore sistematike konform Ligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi;
6. Është përgjegjës për mjetet e punës si: Kasetat, foliet, filmat, zhvilluesit, komorën automatike, racionalizimin e përdorimit të tyre dhe materialit shpenzues si dhe mirëmbajtjes së aparaturës në përgjithësi;
7. Është përgjegjës për cilësinë teknike të egzaminimit radiologjik;
8. Kujdeset për mjetet e punës që disponon shërbimi radiologjik;
9. Kujdeset për konfidencialitetin e pacientit;
10. Është përgjegjës për evidentimin dhe kryerjen e bashkëpagesave për shërbimet e ofruara shëndetësore dhe dorëzimin e tyre në shërbimin kompetent;
11. Dorëzon dozimetrimin për mbikëqyrje të dozave rrezatuese në institucionin e kontraktuar nga QKMF;
12. Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF;
13. Kryen edhe punë të tjera nga lëmia profesionale.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Shkolla e mesme e mjekësisë, bachelor - Teknik i Radiologjisë;
2. Të jetë i licencuar me licencë valide nga MSh/Oda përkatëse;
3. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

X. Emri i grupit: Asistent administrativ - tre (3) ekzekutues.

Institucioni: Komuna e Prishtinës.

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Kategoria e zyrtarit publik: Nëpunës i shërbimit publik.

Klasa e pagës dhe koeficienti: GJ41 / 5.0

Kontrata e punës lidhet: Kohë të pa caktuar, puna provuese gjashtë (6) muaj.

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.

Mbikëqyrësi: Shefi Njesisë për Buxhet dhe Financa, Udhëheqësi i Sektorit të Administratës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Është përgjegjës për dorëzim të bllokave të participimit;
2. Mban evidencën e bllokave të participimit të shpërndarë nëpër njësi organizative të QKMF-së;
3. Bënë pranimin e bllokave të shfrytëzuar nga njësit punuese;
4. Bënë shkarkimin e tyre duke bërë evidentimin e tyre me numra serik;
5. Harton raportin për llogaritjen e bashkëpagesave;
6. Mban librin e protokollit të bllokave të participimit;
7. Barazohet me motrat përgjegjëse sipas nevojës;
8. Bënë edhe punë të tjera në bazë të nevojës me kërkesë të shefit;
9. Kryen dhe punë të tjera nga lëmia e tij përkatëse.

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Shkolla e mesme drejtimi ekonomik-juridik, administrativ;
2. Njohja e punës me kompjuter e domosdoshme.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, kati përdhese në Ndërtesën e Komunës së Prishtinës.

Aplikacioni mund të shkarkohet nga Web Faqja Zyrtare e Komunës së Prishtinës dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Qendrën për Shërbim me Qytetarë (në Sportele) apo të dërgohet me postë në këtë adresë: Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK Nr. 2, Prishtinë, Sektori i Burimeve Njerëzore, Kati II, Zyra Numër 229.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a) Formulari i aplikimit;
- b) Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- c) Kopjet e dokumentacionit të përvojës së punës nëse ka;
- d) Kopjen e licences nga MSh/Oda përkatëse;
- e) Kopjen e dokumentit personal;

Dëshmia se ka zotësi të plotë veprimi, dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerje të veprës penale me dashje dhe diploma e kualifikimit arsimor e noterizuar dorëzohet gjatë fazës së verifikimit para emërimit.

Kandidatët duhet të jenë Shtetas i Republikës së Kosovës.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a) Testimit me shkrim;
- b) Intervistës.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët, si dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes Web faqes së Komunës së Prishtinës (<https://www.prishtinaonline.com>) si dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net/>).

Afati i aplikimit do të jetë tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe në Web faqen e institucionit nga dt. **09.07.2026** deri me dt. **07.08.2026**.

VËREJTJE: Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim, dhe dokumentacioni nuk do të kthehet. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore Nr.229, prej orës 08:00 – 16:00 me adresë Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK nr. 2, Prishtinë.



Broj protokola: 14-111/01-101963/26
Datum: 09.07.2026

